

Një Vështrim mbi Treguesit e Zhvillimit Ekonomik të Shqipërisë

Sekretariati i Këshillit të Investimeve

Prill 2026

Ky publikim është një përmbledhje e treguesve kryesorë makroekonomikë në Shqipëri të publikuara nga burime zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ky dokument nuk paraqet pikëpamjet e Sekretariatit ose Këshillit të Investimeve.



Përmbajtja

- Llogaritë Kombëtare
- Tregtia e Jashtme
- Tregu i Punës
- Investimet
- Tregues Monetar
- Renditja e Shqipërisë referuar Indekseve të publikuar nga institucione ndërkombëtare

Tregues Kryesorë Makroekonomikë 2025


- ❖ Bazuar në të dhënat paraprake nga INSTAT, Produkti i Brendshëm Bruto u rrit me 3,79% në vitin 2025. Mesatarisht, organizatat ndërkombëtare parashikojnë rritje ekonomike më të ulët për periudhën 2026–2027 krahasuar me parashikimet e qeverisë shqiptare.
- ❖ Në vitin 2025, eksportet e mallrave arritën në 346 miliardë lekë, duke rënë me 6,1%, ndërsa importet arritën në 887 miliardë lekë, duke u ulur me 0,8% krahasuar me vitin e kaluar. Si rezultat, deficitit tregtar u zgjerua në 541 miliardë lekë, një rritje prej 3,0% nga viti në vit. Raporti i mbulimit të eksporteve me importet ra në 39%, nga 41.3% në vitin 2024.
- ❖ Inflacioni mesatar vjetor në vitin 2025 ishte 2.2%, duke mbetur nën objektivin prej 3% të Bankës së Shqipërisë. Kredia totale për ekonominë arriti në 843.7 miliardë lekë në dhjetor 2025, duke përfaqësuar një rritje vjetore prej 13%. Kredia e re u drejtua kryesisht drejt tregtisë me shumicë dhe pakicë, ndërtimit dhe prodhimit.
- ❖ Në tremujorin e katërt të vitit 2025, shkalla e papunësisë ishte 8.3% për popullsinë e moshës 15 vjeç e lart, me papunësi më të lartë tek gratë (9.4%) krahasuar me burrat (7.4%).
- ❖ Investimet publike dhe investimet e huaja direkte (IHD) përbënin secila 6.1% të PBB-së në vitin 2025. Remitancat arritën në 1.1 miliardë euro në vitin 2024, ekuivalente me 4,2% të PBB-së.
- ❖ Flukset hyrëse të IHD mbetën të qëndrueshme në 1.63 miliardë euro në vitin 2025. Stoku total i IHD u rrit me 10%, duke arritur në 16.99 miliardë euro. Holanda mbeti investitori më i madh, e ndjekur nga Italia dhe Kosova. Pasuritë e paluajtshme vazhdojnë të jenë sektori më tërheqës për investitorët e huaj, ndërsa bujqësia mbetet më pak tërheqësja.

Vlerësimi sipas Indekseve botërore

- ❖ **Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit** - Shqipëria renditet e 91/180 në rang botëror, duke përkeqësuar pozicionin e saj në 2025 nga viti i kaluar me 11 vende. Shqipëria e ka ulur vlerësimin e indeksit nga nga 42 një vit më parë, në 39 për vitin 2025.
- ❖ **Indeksi i Lirisë ekonomike** - Shqipëria vlerësohet me një indeks të lirisë ekonomike prej 68 duke e bërë ekonominë e saj të 46-ën/184 më të lirë në vlerësimin më të fundit të Lirisë Ekonomike. Ekonomia e Shqipërisë konsiderohet "mesatarisht e lirë" sipas Indeksit të vitit 2026.
- ❖ **Indeksi Global të Inovacionit** - Shqipëria renditet e 67-ta/133 në Indeksin Global të Inovacionit për vitin 2025, e parafundit në rajon duke fituar një vend nga renditja në 2024 por me një përmirësim të dukshëm të indeksit krahasuar me një vit më parë ku renditej 84/133 ekonomi.
- ❖ **Indeksi i Kompleksitetit Ekonomik** - Shqipëria renditet e 81a përta i përket Indeksit të Kompleksitetit Ekonomik, ndërkohë Serbia renditet e 37a me renditjen më të mirë në rajon.
- ❖ **Indeksi i Gadishmërisë së Infrastrukturës në mbështetje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm** - Vlera e indeksit për Shqipërinë është 44.5, duke e renditur në vendin në vendin e 59-të/156 vendet e vlerësuara.


Ecuria e Rritjes Ekonomike

Rritja Ekonomike, Shqipëria dhe Ballkani Perëndimor



Rimëkëmbja ekonomike e Shqipërisë e nisur nga viti 2015, u ngadalësua përgjatë vitit 2019 dhe ra përgjatë vitit 2020 me -3,3%, rënie më e vogël krahasuar me parashikimet fillestare, si rezultat i pandemisë COVID19. Gjatë 2025 rritja vlerësohet 3,8% bazuar në vlerësimet paraprake të INSTAT.

RER, Banka Botërore pranverë 2026




Bazuar në vlerësimet e BB, gjatë vitit 2025, Shqipëria (3,9%), Kosova (3,6%) dhe Maqedonia e Veriut (3,5%) vlerësohen me rritjen më të lartë ndërsa rritja më e ulët vlerësohet në Serbi dhe Bosnië Hercegovina me përkatësisht 2% dhe 2,1%.


BP vlerësohet me një rritje mesatare prej 3,2% përgjatë periudhës 2026-2028.

Ecuria e Rritjes Ekonomike

Vlerësimi i rritjes ekonomike Shqipëria 2025




Vlerësimi Rritja ekonomike Shqipëria 2026 - 2027



Bazuar në të dhënat paraprake të INSTAT, Produkti i Brendshëm Bruto gjatë vitit 2025 në Shqipëri u rrit me 3,79%. Mesatarisht Institucionet ndërkombëtare japin një parashikim më të ulët të rritjes ekonomike për periudhën 2026 - 2027, krahasuar me parashikimet e qeverisë shqiptare.

Rritja Ekonomike sipas Tremujorëve






Produkti i Brendshëm Bruto në terma realë u rrit me 3,80% në tremujorin e katërt të vitit 2025, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024.

Rritja u mbështet kryesisht nga sektori i “Ndërtimit” (+1,17 p.p) dhe “Administrata publike, Arsimi dhe Shëndetësia” (+1,02 p.p).


Nga ana tjetër, disa sektorë ushtruan ndikim negativ, si “Bujqësia, Pyjet dhe Peshkimi” (-0,27 pikë përqindje), “Industria, Energjia dhe Uji” (-0,16 pikë përqindje) dhe “Informacioni dhe Komunikacioni” (-0,11 pikë përqindje). Ndërkohë, “Taksat neto mbi produktet” dhanë një kontribut të konsiderueshëm pozitiv prej +1,54 pikë përqindje.

E Ardhura për Frymë

Për vitin 2024, e ardhura për frymë e Shqipërisë vlerësohet **11.378 USD** në vlerë korrente, 17% më lart se një vit më parë.



Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme




Gjatë vitit 2025, eksportet e mallrave arritën vlerën 346 mld lekë, duke u ulur me 6,1 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 887 mld lekë, duke u ulur me 0,8 %, krahasuar me një vit më parë.

Deficiti tregtar arriti vlerën 541 mld lekë, duke u rritur me 3,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2024.

Përqindja e mbulimit të eksporteve ndaj importeve ra në 39% nga 41,3% në 2024.

Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme

Importe në vite, milionë lekë




Gjatë vitit 2025, importet janë ulur me 0,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024.

Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -1,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,8 pikë përqindje, etj.

Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” dhe “Ushqime, pije, duhan” me +0,7 pikë përqindje.

Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme

Eksporte në vite, në milionë lekë




Eksportet, gjatë vitit 2025 janë ulur me 6,1 %, krahasuar me një vit më parë.

Grupet që kanë ndikuar në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -4,5 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -1,3 pikë përqindje, etj.

Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +0,7 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,6 pikë përqindje.

Importet e Mallrave


Struktura e importeve të mallrave gjatë 2025 dominohet kryesisht nga Makineri pajisje dhe pjesë këmbimi e cila është rritur ndër vite, dhe Ushqime, pije, duhan, e cila qëndron konstante përgjatë viteve.





Eksportet e Mallrave

Eksporte sipas produkteve




Eksportet sipas produkteve vazhdojnë të ruajnë strukturën e tyre të njëjtë me vitin e kaluar.

Ndërkohë, në vështrim të ecurisë nga 2016- 2025, vihet re konsolidim i uljes së përqindjes ndaj totalit të eksporteve të grupit “Tekstile dhe këpucë” dhe një rritje të eksporteve sidomos në grupin Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi.

Qarkullimi i Mallrave-sipas vendeve partnere

Eksporte sipas vendeve kryesore partnere, në milionë lekë




Shkëmbimet tregtare, për vitin 2025, me vendet e BE-së zënë 57,0 % të gjithë tregtisë. Eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72,5 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,0 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (26,8 %), Kina (10,5 %), Greqia (7,6 %) dhe Turqia (7,3 %).

Gjatë vitit 2025 vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (10,4 %), Kosova (8,6 %) dhe Maqedonia e Veriut (23,9 %).

Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Greqia (7,9 %) Gjermania (1,9 %) dhe Spanja (19,9 %).

Qarkullimi i Mallrave-sipas vendeve partnere

Importe sipas vendeve kryesore partnere, në milionë lekë





Në periudhën Janar – Dhjetor 2025 importet nga vendet e BE-së zënë 51 % të importeve gjithsej.

Gjatë vitit 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (2,0 %), Turqia (11,8 %) dhe Gjermania (5,9 %).

Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritje më të madhe janë: Kina (21,6 %), Greqia (3,0 %) dhe Kosova (2,3 %).


Eksportet në Shërbime - Konteksti Rajonal



Edhe gjatë vitit 2024, Shqipëria vazhdon të renditet e dyta në rajon përsa u përket eksportit të shërbimeve. Serbia është e para në rajonin e Ballkanit Perëndimor përsa i përket eksportit të shërbimeve. Ndërkohë Shqipëria ka përmirësuar disi renditjen në rajon përsa i përket eksportit në Shërbime ICT.

Importe në Udhëtime - Konteksti Rajonal


Importet në udhëtime (% ndaj Importeve në Shërbime)



Shqipëria renditet e para në rajon përsa i përket % së importeve në udhëtime ndaj importit të shërbimeve.

Gjatë 2024 ky tregues ishte 77,7% e totalit të importit të shërbimeve. Vendi i dytë në radhë është Kosova me 47,9% e ndjekur nga Bosnia dhe Hercegovina me 38,3%.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit




Rritja mesatare vjetore e çmimeve në vitin 2025 është 2,2% në të njëjtat nivele me ato të një viti më parë.

Bazuar edhe në të dhënat e grafikut, duke filluar nga fundi i vitit 2011, inflacioni mujor me bazë vjetore ka qenë vazhdimisht poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3%, por tendeca rritëse janë vënë re duke filluar nga muaji Nëntor 2021, ku Inflacioni i regjistruar tejkaloi objektivin e BSH dhe arriti kulmin në muajin Tetor 2022, me 8,3%. Duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2024, inflacioni ra nën objektivin e BSH prej 3%.

Kursi i këmbimit

Ecuria e kursit të këmbimit, USD/ALL, EURO/ALL




Përgjatë vitit 2025, kursi mesatar i këmbimit lekë/Euro ishte 97,8 ndërsa lekë/USD ishte 86,7.




Kredia për ekonominë

Kredia për ekonominë, në milionë lekë



Kredia e re per ekonomine (mln lekë)




Kredia totale për ekonominë arriti në 843,7 miliardë lekë në dhjetor 2025, 13% rritje krahasuar me dhjetor 2024. Ndërkohë, shumica e kredisë së re gjatë vitit 2025 shkoi sërisht drejt tregtisë me shumicë dhe pakicë, Ndërtimit dhe Industrisë përpunuese.

Burimi: BSH



Forca e Punës


Norma e papunësisë




Në Tremujorin IV 2025, bazuar në të dhëna paraprake shkalla e papunësisë regjistroi shifrën 8,3% për popullsinë 15+, më e lartë tek femrat (9,4%) sesa tek meshkujt (7,4%).

Paga Mesatare Sipas Sektorëve

Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas aktiviteteve ekonomike në Lekë




Hendeku Gjitor në paga (%)



Në 2024, pagat më të larta janë regjistruar në “Aktivitete financiare dhe të sigurimit”, pasuar nga “Informacioni dhe Komunikimi”, trend i konsoliduar tashmë. Pagat më të ulta janë raportuar në sektorin “Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim”. Gjatë 2024 vihet re rritje e pagës mesatare të raportuar në të gjithë sektorët, (mesatarisht 9%). Hendeku gjitor në paga në Shqipëri vlerësohet në +4,9% për vitin 2024 në ulje nga një vit më parë.

Paga Mesatare dhe Paga minimale

Paga bruto në lekë




Paga mesatare gjatë TIV 2025 është raportuar në **76,489 lekë** nga 77,485 në vitin 2024, me rënie 1,3% krahasuar me pagën e raportuar në 2024..

Paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin privat ishte **70,591 lekë**, 0,8% rënie krahasuar me vitin 2024 ndërkohë paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin shtetëror u raportua në **90,103 lekë**, me rënie **2,1%** krahasuar me shifrën e vitit 2024.

Paga minimale raportohet **40,000 lekë** që nga nga TII 2023.

Kosto e Punës për Vendet e Ballkanit Perëndimor


Paga mesatare për një të punësuar në EURO



Shqipëria vazhdon të ketë pagën mesatare më të ulët në rajon së bashku me Kosovën.

Investimet Publike, Private dhe IHD



Investimet Publike, Formimi Bruto I Kapitalit Fiks and IHD



Gjatë vitit 2025, Investimet publike arritën 6,1% të PBB, kurse Investimet e Huaja Direkte 6,1% të PBB.



Remitancat në 2024 regjistruan shifrën 1.119 million Euro, sa 4,2% e PBB.

Investimet private në ekonomi



Sipas Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, gjatë 2024, investimet private u rritën me 12%; ndërkohë vërehet rritje më e lartë tek prodhuesit e shërbimeve. Kryesisht investimet gjatë vitit 2024 kanë shkuar për Makineri dhe pajisje me rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë.



Investimet e Huaja Direkte



Gjatë vitit 2025, fluksi hyrës i IHD paraqitet në të njëjtat nivele me një vit më parë. Edhe pse flukset hyrëse të IHD kanë qënë mjaft të ndryshueshme sipas cikleve të biznesit, që nga 2015 stoku i IHD në Shqipëri ka ruajtur një trend rritës deri ne TIV 2019 dhe ka filluar sërisht rimëkëmbjen gjatë TII 2020. Gjatë vitit 2025, flukset e IHD arritën 1.635 mln Euro, 837 milionë Euro janë fitimet e riinvestuara të cilat kanë pësuar rritje duke filluar nga viti 2017. Ndërkohë, gjatë vitit 2025, stoku I IHD u rrit me 10% krahasuar me një vit më parë duke arritur 16.995 milionë Euro.





Investimet e Huaja Direkte



Flukset e Investimeve të Huaja në Shqipëri ruajtën të njëjtin trend edhe përgjatë vitit 2025, 6,1% të PBB, ndërsa stoku IHD ra në 57,8% të PBB.

Investimet e Huaja Direkte




Gjatë 2025, Holanda është vendi me fluksin më të lartë të IHD, 202 milionë Euro, ndjekur nga Italia dhe Kosova, respektivisht me 187 dhe 186 milionë Euro. Vërehet një rënie e flukseve hyrëse nga Turqia e cila një vit më parë udhëhiqte me 257 milionë Euro.

Ndërkohë, në TIV 2025, Holanda vazhdon të udhëheqë stokun e IHD-ve, duke arritur në 2.761 milionë Euro e ndjekur nga Zvicra me 2.348 mln Euro.

Investimet e Huaja Direkte


Fluksi IHD sipas aktivitetit ekonomik në milionë Euro



Gjatë vitit 2025, Investimet në pasuri të paluajtshme ngelen aktiviteti më i preferuar për investitorët e huaj të cilët kanë investuar deri në 561 milionë Euro, 48% më shumë se një vit më parë.

Ndërkohë, Bujqësia, pyjet dhe peshkimi janë aktiviteti më pak tërheqës për investitorët e huaj në vend.


Fluksi i IHD në Ballkanin Perëndimor



Gjatë vitit 2024, Kosova udhëheq rajonin përsa i përket Flukseve të IHD në raport të PBB, 7,7%. Shqipëria ndërkohë renditet e treta në rajon me 6,3% të PBB.

Vërehet një rritje e IHD kryesisht në Maqedoninë e Veriut me rritje gati 50% krahasuar me një vit më parë.

Fluksi i IHD në Ballkanin Perëndimor



Flukset hyrëse të IHD në Serbi ishin **5,6 miliardë USD** për vitin 2025, ndërsa në Shqipëri ato kapën shifrën e **1,7 miliardë USD**

Vendi me më pak flukse hyrëse të IHD në rajon për vitin 2023 është Mal i Zi me 599 milion USD.

Maqedonia e Veriut ka përjetuar rritjen më të lartë të flukseve të IHD me 60% e ndjekur nga Mal i Zi me 14%. Ndërkohë Bosnia dhe Hercegovina ka përjetuar uljen më të lartë në rajon me rreth 125 milionë USD më pak.

Stoku Dhe Profili i Ndërmarrjeve

Struktura e ndërmarrjeve në ekonominë shqiptare dominohet nga ndërmarrje të vogla me 1-9 të punësuar 94% e totalit dhe sigurojnë 38% të të punësuarve në vend për vitin 2025.

Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet që prodhojnë të mira e shërbime në Shqipëri. për të gjitha format legale (nuk përfshihen aktivitetet e bujqësisë, peshkimit, aktivitetet e ndërmjetësimit monetar dhe financiar, administrata publike dhe e mbrojtjes si edhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare)


Treguesit	Numri i ndërmarrjeve					
Viti	2019	2020	2021	2022	2023*	2024
Ndërmarrjet Mikro (1-9 të punësuar)	96,924	95,558	97,022	106,132	109,661	112,412
Ndërmarrjet e Vogla (10-49 të punësuar)	5,736	5,674	5,608	5,842	6,176	6,018
Ndërmarrjet e Mesme (50-249 të punësuar)	1,251	1,173	1,227	1,306	1,286	1,267
NVM (1-249 të punësuar)	103,911	102,405	103,857	113,279	117,123	119,697
Ndërmarrjet e Mëdha (250+ të punësuar)	179	169	174	181	168	174
Gjithsej	104,090	102,574	104,031	113,460	117,292	119,870

Treguesit	Numri i të punësuarve					
Viti	2019	2020	2021	2022	2023*	2024
Ndërmarrjet Mikro (1-9 të punësuar)	196,403	186,400	191,250	206,598	212,212	208,423
Ndërmarrjet e Vogla (10-49 të punësuar)	114,451	111,347	111,318	115,007	120,564	118,818
Ndërmarrjet e Mesme (50-249 të punësuar)	122,330	114,767	121,002	128,026	129,322	124,741
NVM (1-249 të punësuar)	433,184	412,514	423,570	449,631	462,098	451,981
Ndërmarrjet e Mëdha (250+ të punësuar)	97,669	91,472	95,669	98,311	97,824	99,208
Gjithsej	530,853	503,986	519,240	547,942	559,922	551,189

Burimi: Burimi: Anketa Strukture prane Ndërmarrjeve
*Të dhënat e publikuara do të jenë objekt revizionimi

Perspektiva e Konkurrueshmërisë së Ballkanit Perëndimor - OECD

★ ALB ◆ BP6




Shqipëria në 2024 ka bërë përpertime të rëndësishme që nga Perspektiva e Konkurrencës 2021, duke përpertuar pozitivisht në 14 nga 15 dimensionet e politikave por ka ngecur tek dimensionet e ndërmarrjeve shtetërore.

Shqipëria përjetoi rritjet më të forta të rezultateve në fushat e antikorrupsionit, politikës tregtare dhe politikave bujqësore dhe e kalon mesataren e Ballkanit Perëndimor (BP6) në 13 dimensionet e politikave.

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit

Indeksi i Perceptimit të korrupsionit, renditja 180 vende




Shqipëria renditet e **91/180** në rang botëror, duke përkeqësuar pozicionin e saj në 2025 nga viti i kaluar me 11 vende. Shqipëria e ka ulur vlerësimin e indeksit nga nga 42 një vit më parë, në 39 për vitin 2025.

Mal i Zi ka renditjen më të mirë nga të gjitha gjashtë vendet ne rajonin e Ballkanit Perëndimor (65/180), i ndjekur nga Kosova (76/180).

Renditjen më të ulët e shënon Serbia (116/180) e ndjekur nga Bosnia dhe Hercegovina (109/180).

Liria Ekonomike

Liria Ekonomike, 177 vende të vlerësuara



Rezultatet për Indeksin e Lirisë Ekonomike bazohen përgjithësisht në të dhënat për periudhën që mbulon gjysmën e dytë të vitit t-2 deri në gjysmën e parë të vitit t-1

Shqipëria vlerësohet me një indeks të lirisë ekonomike prej 68 duke e bërë ekonominë e saj të 46-ën/184 më të lirë në vlerësimin më të fundit të Lirisë Ekonomike.


Vlerësimi i saj është rritur me 1,4 pikë nga viti i kaluar dhe Shqipëria renditet e 25-ta nga 44 vende në rajonin e Evropës.

Rezultati i lirisë ekonomike të vendit është më i lartë se mesatarja botërore dhe më i ulët se mesatarja rajonale.

Ekonomia e Shqipërisë konsiderohet "mesatarisht e lirë" sipas Indeksit të vitit 2026.

12 Liritë Ekonomike 2026

12 Liritë Ekonomike




Shqipëria vlerësohet më mirë për sa i përket kostos së Taksave dhe Shëndetit fiskal, ndërsa vlerësimin më të ulët e rregjistron në Integritetin qeverisës dhe Lirinë e punës.

Rezultatet për Indeks të Lirisë Ekonomike bazohen përgjithësisht në të dhënat për periudhën që mbulon gjysmën e dytë të vitit t-2 deri në gjysmën e parë të vitit t-1

Burimi: www.heritage.com


Treguesit e Lirisë Ekonomike - Indeksi 2026

Liria ekonomike - Sundimi i ligjit



Sundimi i ligjit, në përgjithësi, respektohet në një nivel relativisht të kënaqshëm në Shqipëri. Vendi renditet mbi mesataren globale për sa i përket të drejtave të pronës dhe efektivitetit të sistemit gjyqësor, ndërsa për integritetin e qeverisë rezultati mbetet nën mesataren botërore.


Liria ekonomike - Efektiviteti Rregullator



Mjedisi rregullator në Shqipëri, në përgjithësi, paraqitet relativisht i konsoliduar në aspektin institucional, por mbetet i kufizuar për nga efikasiteti. Vendi shënon një rezultat shumë mbi mesataren botërore për lirinë e biznesit dhe lirinë monetare, ndërkohë që për lirinë e punës renditet nën mesataren globale.


Treguesit e Lirisë Ekonomike - Indeksi 2026

Liria ekonomike - Madhësia e qeverisë



Norma maksimale e tatimit mbi të ardhurat personale është 23%, ndërsa ajo mbi fitimin e korporatave është 15%. Të ardhurat tatimore përbëjnë 17.8% të PBB-së. Mesatarja trevjeçare e shpenzimeve qeveritare është 29.3% e PBB-së, ndërsa bilanci buxhetor paraqet një deficit mesatar prej 1.9% të PBB-së. Borxhi publik arrin në 56.0% të PBB-së.


Liria ekonomike - Liria e Tregut



Norma mesatare e tarifave, e ponderuar sipas tregtisë, është 3.5%, ndërsa janë në fuqi mbi 190 masa jo-tarifore. Në tërësi, hapja ndaj investimeve të huaja është mbi mesataren globale, por kuadri ligjor për investimet karakterizohet nga mungesë transparence. Sektori bankar mbetet relativisht i mirëkapitalizuar, pavarësisht mjedisit sfidues.

Indeksi Global i Inovacionit - Renditja në nivel global 2025

Indeksi Global i Inovacionit (Renditja 133 ekonomi)




Shqipëria renditet e 67-ta/133 në Indeksin Global të Inovacionit për vitin 2025, e parafundit në rajon duke fituar një vend nga renditja në 2024 por me një përmirësim të dukshëm të indeksit krahasuar me një vit më parë ku renditej 84/133 ekonomi.

Serbia kryeson rajonin në Inovacion (54/133) sipas raportit më të fundit të GII e ndjekur nga Maqedonia e Veriut (63/133).

Indeksi Global i Inovacionit - Renditja 2025

Indeksi Global i Inovacionit, Renditja 133 ekonomi për 2024




Shqipëria renditet ulët në Kërkim dhe kapital njerëzor, Sofistikim i tregut dhe Njohuri dhe prodhimi teknologjik dhe Prodhimi kreativ.

Më mirë Shqipëria renditet në Institucione dhe Infrastruktura.

Indeksi i Kompleksitetit Ekonomik - Renditja 2024

Indeksi i Kompleksitetit Ekonomik (Renditja botërore)




Shqipëria renditet e 81a përsa i përket Indeksit të Kompleksitetit Ekonomik, ndërkohë Serbia renditet e 37a me renditjen më të mirë në rajon.

Në 3 vendet e para renditen Zvicra, Japonia dhe Taivani.

Indeksi i Kompleksitetit Ekonomik - Rendit vendet bazuar në sa e larmishme dhe komplekse është shporta e tyre e eksportit. Vendet me kompleksitet të lartë kanë game të gjerë aftësish të sofistikuara dhe të specializuara dhe për këtë arsye janë në gjendje të prodhojnë një grup shumë të larmishëm produktesh komplekse

Indeksi i Gadishmërisë së Teknologjive - Renditja 2024




Shqipëria përfshihet në grupin e vendeve që vlerësohen **poshtë-mesatares**, në dallim nga vendet e tjera të BP të cilat klasifikohen mbi-mesataren.

BP	Vlerësimi	Renditja 2024
SRB	mbi-mesatare	48
MNE	mbi-mesatare	71
MKD	mbi-mesatare	63
BiH	mbi-mesatare	81
ALB	poshtë-mesatare	89


Indeksi i gatishmërisë së teknologjisë kufitare të avanzuara tregon se sa të përgatitura janë vendet për të adoptuar dhe përshtatur teknologjitë kufitare të avancuara. Ai llogaritet nga UNCTAD jep rezultate për 166 ekonomi të cilat klasifikohen në 4 grupe: e ulët, poshtë-mesatares, sipër-mesatare dhe i lartë.

Indeksi i Gadishmërisë së Infrastrukturës për Zhvillim të Qëndrueshëm

5 Dimensionet e Indeksit Shqipëria 2024



Renditja sipas Indeksit 2024 Ballkani Perëndimor



Vlera e indeksit për Shqipërinë është 44.5, duke e renditur në vendin në vendin e 59-të/156 vendet e vlerësuara.

Renditjen më të mirë në BP e ka Serbia e cila renditet e 43/156, ndërsa renditjen më të ulët e ka Mal i Zi (101/156)

Indeksi QI4SD përmbledh gjendjen e zhvillimit të gatishmërisë së Infrastrukturës së Cilësisë për të mbështetur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm